



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:249170
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05871516

CAP.nr.1822/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtarja individuale Nora Bllaca-Dula, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “O.....” shpk me seli në G.....Komuna e I....., kundër debitorit “B.....” shpk , me seli në P..... Rr. “.....”, baza juridike borxh në bazë (dokumentit të besueshëm), duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga debitori, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër të lëndës Ep.nr.290/2022, të datës 08.09.2023, me datë 25.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit “B.....” shpk , me seli në P..... Rr. “.....”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër të lëndës Ep.nr.290/2022, të datës 08.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë, Departamenti i përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar Ep.nr.290/2022, të datës 08.09.2023, ka vendosur si në vijim: “I. Gjykata Themelore në Pejë – Departamenti i përgjithshëm - Divizioni Civil, shpallet jo kompetent në pikëpamje lëndore, për të vendosur në çështjen përmbarimore të kreditorit “O.....” shpk me seli në G.....K. I....., kundër debitorit “B.....” shpk , me seli në P..... Rr., Zh....., baza juridike borxh në bazë faturës (dokumentit të besueshëm) në vlerë prej 15.898.00€.

II. Pasi që ky Aktvendim të merr formën e prerë, lënda i dërgohet Gjykatës Komerciale - Dhomës së Shkallës së Parë”.

Kundër këtij aktvendimi në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet ankesa, kurse aktvendimi i atakuar të priset dhe çështja t'i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kreditore, nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP) dhe gjeti se:

-Ankesa e të debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditore me datë 01.11.2022, ka parashtruar propozim për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm- faturave, në shumën prej 15.898 € euro, me të cilin ka kërkuar që të caktohet përmbarimi dhe të detyrohet debitori që kreditore, t'ia paguaj borxhin sipas faturave në afat prej 7 ditësh pas pranimit të urdhrimit me kamatë prej 8%, nga data arritshmërisë për pagesë, si dhe shpenzimet përmbarimore.

Përmbaruesi Privat Sh.A, në Pejë në cilësinë e organit përmbarues, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditore ka nxjerr urdhrin P.nr.130/22, të datës 01.11.2022, me të cilin e ka lejuar përmbarimin e propozuar.

Kundër urdhrimit mbi lejimin e përmbarimit debitori ka paraqitur prapësim me të cilin ka kërkuar që të aprovet prapësimi i debitorit, të shfuqizohet urdhri për përmbarim i përmbaruesit privat dhe të anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra.

Kreditore ka parashtruar përgjigje në prapësim duke i cilësuar pretendimet e debitorit si të pa qëndrueshme dhe të pabazuara me propozim që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar, dhe të vërtetohet urdhri për përmbarim P.nr.130/2022, i datës 01.11.2022.

Gjykata e shkallës së parë pas analizimit të shkresave të lëndës, ka vlerësuar se në çështjen konkrete juridike nuk ka kompetencë për të gjykuar. Prandaj me aktvendimin e atakuar ka vendosur që të shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, me arsyetimin se palë në këtë çështje janë shoqëritë tregtare-personat juridik, ku për kontestet e kësaj natyre është kompetente Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka bazuar në dispozitat e nenit 13 paragrafi 1të Ligjit për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 17 paragrafi 1 dhe 2, lidhur me nenin 19 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit

e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK, prandaj, në situatën konkrete të gjitha pretendimet ankimore të debitorit Gjykata e Apelit i konsideron të pabazuara dhe të paqëndrueshme, ngase nuk kanë bazë në prova konkrete.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit se aktvendimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, e pranon në tërësi vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë së e njëjta nuk ka kompetencë lëndore për të vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, pasi që të dy palët, si kreditori ashtu edhe debitori e kanë cilësinë e shoqërisë tregtare siç përcaktohet me Ligji Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare, dhe Ligjin Nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe kjo çështje përmbarimore ka të bëjë me raportet e tyre afariste. Në bazë të nenit 13 par.1, pika 1.1, dhe 1.2 të Ligjit Nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, është paraparë së *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre; të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”*. Sipas paragrafit 2 të këtij neni *“Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Ekonomike”*. Në bazë të nenit 17 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, është paraparë se: *“Në procedurën përmbarimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër. Sipas nenit 17 dhe 19 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së), parashihet që gjykata gjatë tërë procedurës sipas detyrës zyrtare kujdeset për kompetencën e vet lëndore.*

Prandaj, bazuar në dispozitat e sipërcituara vërtetohet fakti së Gjykata Themelore në Pejë, nuk ka kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje përmbarimore, dhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka marrë vendim për t’u shpallur jo kompetente në pikëpamjen lëndore, ashtu që lënda t’i dërgohet Gjykatës Komerciale, Dhomës së shkallës së parë, si gjykatë kompetente sepse në rastin konkret në këtë çështje juridiko përmbarimore palë ndërgjyqëse janë subjekte afariste – shoqëritë tregtare që ushtrojnë veprimtari ekonomike.

Gjykata e Apelit i mori parasysh edhe të gjitha pretendimet të tjera ankimore të debitorit, por të njëjtat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe nga kjo që është vendosur.

Numri i lëndës: 2022:249170
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05871516

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 209 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1822/2023, datë 25.06.2024

Gjyqtarja,
Nora Bllaca-Dula, d.v